



VENDIM

Nr. 33 Date 13.10.2014

PER MIRATIMIN E RREGULLORES SE FUNKSIONIMIT DHE ADMINISTRIMIT TE
“PARKUT NATYROR RAJONAL NIKAJ-MERTUR”

Keshilli i Qarkut Kukës në mbledhjen e tij të datës së mesipërme, pas shqyrtimit të Relacionit të paraqitur nga AZHR-ja, bazuar në ligjin Nr.8652 datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore,, nenet 7/2, 8/1/1/b,13, 54/1/n, ligjin Nr.8485 datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, ligjin Nr. 9868, datë 04.02.2008 “Për zonat e mbrojtura”, (i ndryshuar) neni 11/1, VKM Nr.519, datë 30.06.2010 “Për procedurat e propozimit e të miratimit dhe rregullat e administrimit të parqeve natyrore rajonale” pika 5/d, si dhe në vendimin e Keshillit të Komunes Lekbibaj Nr.18 datë 20.08.2014 “Për krijimin e administratës për ruajtjen dhe menaxhimin e parkut natyror rajonal Nikaj-Mertur”, si dhe vendimin e Kryesise së Keshillit të Qarkut Kukës, Nr.20, datë 13.10.2014 “Për miratimin e P/Akteve për mbledhjen e Keshillit të Qarkut Kukës”.

VENDOSI:

1. Miratimin e Rregullores së funksionimit dhe administrimit të “Parkut Natyror Rajonal Nikaj-Mertur”, bashkangjitur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen, Sekretari i Keshillit të Qarkut Kukës, Agjensia e Zhvillimit Rajonal, si dhe Komuna Lekbibaj.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

KRYETARI
Ibsen ELEZI

